



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

Numri i lëndës: 2020:024269

Datë: 18.02.2021

Numri i dokumentit: 01516871

P.nr.10/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN ,DEGA NË NOVOBËRDË-
Departamenti i Përgjithshëm,përmes gjyqtares Emine Salihu, me Ref. e lartë Mimoza Mehmeti, në lëndën penale kundër të akuzuarit S. V., nga Fsh.K., K.Novobërdës, për shkak të veprës penale Sulm nga neni 184 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së, të cilin e mbron Av.Hasan Sadiku, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan Departamenti i përgjithshëm PP.II.nr.216/20 të datës 07.02.2020, të cilën e përfaqësonte prokurja e shtetit Sllavica Popoviq, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datë 08.02.2021, në prezencë të palëve mori dhe shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri S. V., me pseodonim "D." nga i ati Zh., dhe e ëma V., e lindur V.,i lindur më dt. 02.06.1952, në fsh. K..., K.Novobërdës, ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme te makinerise, i martuar, babë i dy fëmijëve, pensioner, i gjendjes së mesme ekonomike, serb, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë për ndonjë vepër tjetër penale.

Është fajtor

Sepse ,

-Më datë 01.02.2020, rreth orës 21.00 minuta, ne Fsh.K., te Komunës së Novobërdës, në lokalitë të tij i cili ndodhet përballë shkollës për shkak të një zënke të momentit dhe rreth menyres se shfrytezimit te nje aparati të "Pikados", me dashje dhe pa pëlqimin e tij ka përdorur forcën ndaj viktimës së ndjeshme- të dëmtuarit te mitur Ll....., nga K., në atë menyrë që të njëjtin e kap për dore , e shtyn dhe më pas edhe e godet me shuplake ne fytyre dhe e perze nga lokali duke e fyer me fjalë të ndyta , mirpo sipas raportit të policisë dhe atij të emergjencës

së SR të Gjilanit, me nr.2626 të datës 01.01.2020 nuk i kishte shkaktuar edhe ndonjë lëndim trupor.

- me çka ka kryer veprën penale Sulm nga neni 184 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së,

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e cituara ligjore ,nenin 4, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69, 71, 72, të KPRK-së, i dhe nenin 365 dhe 451 të KPPK-ës të akuzuarin,

E GJYKON

Për veprën penale të dispozitivit të aktakuzës me dënim me burgim në kohë zgjatje prej 4 muajve, të cilin dënim i pandehuri nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 viti nga dita kur aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale e në të kundërtën gjykata do t'ia revokoj dënimin me kusht.

Përfaqsesi ligjor i të dëmtuarit (të miturit) Ll. Zh..., prindi i tij nga Fsh.K., K.Novobërdës, për realizimin e kërkesës paurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil .

Obligohet i akuzuari ti paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 25 € (njëzet e pesë euro)si dhe në emër të harxhimeve procedurale shumë e përlllogaritur në llogarinë përfundimtare të kësaj gjykate, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në konform të nenit 39 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit për kompenzimin e viktimave të krimit i akuzuari S. V..., obligohet të paguaj taksën në shumë prej 30 euro.

A r s y e t i m

Prokuroria Temelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.216/20 të datës 07.02.2020, ndaj të pandehurit S. V..., nga fsh. K. K, Novobërdë, për shkak të veprës penale Sulm nga neni 184 par.3 nën par.3.2 të KPRK-së,

I pandehuri S.V..., pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 08.02.2021, deklaroj: se aktakuzën e lexuar nga ana e prokurores së shtetit e kam kuptuar në tërësi, e ndiej vehtënj fajtor dhe e pranoj fajsinë, është hera e parë që ndeshem me ligjin, nuk i kam ditur pasojat e kësaj vepre penale, i premtoj gjykatës se një veprim të tillë nuk do ta përsërisë dhe kërkoj nga gjykata që të më shqiptoj një dënim sa më të butë. Nga dita kur e kam kryer këtë veper penale unë përdori

terapi shtesë për 10 % më tepër në krahasim me dozën e kaluar. Sigurisht po të ishin prezent prindërit e të demtuarit do ti kërkoja falje publike në gjykatë.

Mbrojtësi i të pandehurit S... V., Av.Hasan Sadiku, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 08.02.2021, deklaroj:Meqense i mbrojturi im në tërësi e ka pranuar fajësinë për veprën penale të cilën ia vë në barrë aktakuza mua si mbrojtës nuk më mbetet tjetër pos ti propozoj gjykatës që këtë pranim të fajësisë ta aprovoj pasi që i njëjti është dhënë në bazë ligjore –vullnetarisht dhe në konsultim me mua. Andaj edhe i propozoj gjykatës që me rastin e matjes së lartësisë së dënimit si rrethana posaqërisht lehtësuese ta merr faktin se për ndermarjen e veprimeve të cekura në aktakuzë nga ana e të akuzuarit ka qenë i shtyer nga vet i dëmtuari pasi që i njëjti me parë me grusht e ka goditur pikadon.Gjithashtu i propozoj gjykatës që si rrethanë lehtësuese të merr edhe pranimin e fajësisë, pendimin si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të ndermarre veprime të tilla apo të ngjashme. Andaj i propozoj gjykatës që të japë një dënim të kushtezuar.

Prokurorja e shtetit Sllavica Popoviq, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 08.02.2021, deklaroj: Duke pasur parasysh se pranimi i fajësisë është i mbështetur me të gjitha provat e propozuara në aktakuzë, jam e mendimit se janë plotësuar kushtet ligjore qe gjykata në tërësi ta pranoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit S.. V....

Pas dëgjimit të prokurores së shtetit, mbrojtësit të të akuzuarit S. V., Av.Hasan Sadiku, dhe të akuzuarit, gjyqtarja e vetme gjykuese konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore ,nga neni 248 paragrafi 2 të KPP për pranimin e fajësisë ,nga se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri,pranimi mbështetet nga faktet e çështjes nga aktakuza e cila nuk përmban as një shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj ,duke u bazuar në këtë që u cekën më lartë ,gjykata e vërtetoi gjendjen faktike :

Se i pendehuri S.. V..q, nga fsh. K..ë, K.Novobërdës, e ka kryer veprën penale Sulm nga neni 184 par.3 nën par.3.1 lidhur me par. 1 të KPRK-së,

Gjyqëtarja e vetëme gjykuese, shpalli fajtor të pandehurin S... V..., për veprën e cekur më lartë nga se veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe përgjegjës penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit të pandehurit gjykata ia ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ,sipas nenit 73,të KPRK-së ku si rrethanë veçanarishtë lehtësuese gjykata e ka marrë për bazë faktin se i pandehuri e ka pranuar fajsinë, sjelljen korrekte në gjykatë ,ka shprehur keqëardhje për kryerjen e kësaj vepre , është penduar si dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale . Ndërsa , nuk ka gjetur ndonjë rrethanë pasaqërisht rënduese.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, caktimi i dënimit me kusht ndaj të pandehurit S. V., është dënim i drejtë , në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit ,si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit ,nga neni 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 të KPRK-së.

Vendimi për kërkesën pasurore është marrë duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 1.2 të KPRK-së.

Nga të cekurat e më sipërme e në bazë të nenit 365 të KPPK-ës,u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË NOVOBËRDË
Departamenti i përgjithshëm
P.nr.10/2020
Më:08.02.2021

Ref. e lartë
Mimoza Mehmeti

Gjyqtarja
Emine Salihu

KËSHILLA JURIDIKE :*Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në gjykatën e Apelit në Prishtinë ,në afate prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit .Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj gjykate.*

Numri i lëndës: 2020:024269
Datë: 18.02.2021
Numri i dokumentit: 01516871